

Xhemile Saliu, PhD¹

UDC: 347.441.42:340.13(497.7)

**PROBLEMET THEMELORE TË SISTEMIT GJYQËSOR CIVIL
HOLANDEZ DHE PËRPJEKJET PËR REFORMA**

**ОСНОВНИ ПРОБЛЕМИ НА ХОЛАНДСКИОТ ГРАЃАНСКИ
СУДСКИ СИСТЕМ И НАПОРИ ЗА РЕФОРМИ**

**BASIC PROBLEMS OF THE CIVIL JUDICIAL SYSTEM OF
NETHERLANDS AND REFORM PROCEDURES**

Abstract

In the Dutch judicial system, the rules of law generally are applied. In Netherland, a judge's decision is binding. This means that everyone, including those who did not request that judgment, must comply with the court's decision. Because this can have major consequences, high demands are placed on the judge. A judge is only appointed after a rigorous selection, if he has received a thorough education and is of impeccable behavior. The judge derives part of his authority from this. Another important condition for fair justice is that a judge is independent.

Therefore judges are appointed for life. Barring exceptional situations, they do not have to justify themselves to the minister, parliament or each other. Judges must also be objective.

They must not have the same (or conflicting) interests as either parties in a lawsuit. In order to prevent problems in the Dutch civil judicial system as well as to prevent the escalation of litigation in the Netherlands, in order to speed up court proceedings and in order to

¹ Doc. Dr. Professor at International Balkan University - Faculty of Law. ОPMИ. Email: xhemile.saliu@ibu.edu.mk

increase the possibilities for resolving disputes outside the court, several processes have been developed that completely hinder the direction of the parties towards the courts. This applies to resolving more specific processes, where Dutch citizens are offered other out-of-court methods, which also have tremendous impact. And these and similar reforms which will be mentioned in this scientific paper, are made in order to reduce delays.

Keywords: *rules of law, Dutch civil judicial system, preventing the escalation of litigation in the Netherlands, out- of-court methods, efforts for reforms in Netherland civil judicial system.*

PROBLEMET THEMELORE TË SISTEMIT GJYQËSOR CIVIL HOLANDEZ DHE PËRËPJEKJET PËR REFORMA

Sistemi gjyqësor në Holandë në përgjithësi punon mirë. Prandaj mund të thuhet se sistemi gjyqësor i Holandës nuk përballet me probleme të mëdha. Duke iu drejtuar gjykatës, paditësit brenda një afati të arsyeshëm dhe me një shumë solide mbi shpenzimet gjyqësore, arrijnë deri tek një vendim (verdict) gjyqësor dhe mbi të gjitha është i mirë fakti se, gjykatat janë në dispozicion të palëve, sa herë që palët kanë nevojë për një shërbim gjyqësor.

Për zgjidhjen e proceseve më specifike, shtetasve holandezë u ofrohen metoda të tjera jashtë gjykatës, të cilat gjithashtu kanë ndikim të jashtëzakonshëm, sepse, tek e fundit, qëllimi i reformave është reduktimi i vonesave. Shpenzimet gjyqësore janë në përputhje me shumën e kontestit. Avokatët paguhen për punën e bërë, duke u llogaritur puna e tyre për çdo orë. Shumat në orë nëse krahasohen me ato të sistemit juridik anglo-amerikan (Ligji i Përbashkët- Common Law), këto shuma tek sistemi euro-kontinental janë shuma të arsyeshme. Për palën procedurale që e ka fituar kontestin në krahasim me palën që e ka humbur kontestin, nëse gjykata nuk e vendos të kundërtën, zbatohet një metodë e cila i mundëson marrjen e të drejtës t'i fitojë shpenzimet gjyqësore dhe shumën mbi pagesën e avokatit nga pala që ka humbur kontestin. Sa i përket kërkesave të vogla (*small claims*), shpenzimet mund të tejkalojnë shumë lehtë sasinë e shpenzimeve gjyqësore dhe për shkak

të këtij realiteti, paditësit kërkojnë mënyra të reja alternative për të zgjidhur kontestet dhe mosmarrëveshjet e tyre².

Me qëllim që të bëhet parandalimi i zmadhimit të proceseve gjyqësore në Holandë, me qëllim që të përshpejtohen procedurat gjyqësore dhe me qëllim që të rriten mundësitë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (kontesteve) jashtë gjykatës, janë zhvilluar disa procese që pengojnë tërësisht drejtimin e palëve drejt gjykatave. Andaj, për këtë gjë janë ofruar mundësi të ndryshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet (kontestet) jashtë gjykatës. Shikuar teknikisht, procedurat serike dhe të thjeshta (*kort geding*)³, të cilat ofrohen si masa të përkohshme, u është zgjeruar jozyrtarisht fushëveprimi i tyre dhe janë konvertuar në procedura të rregullta.

Në këtë procedurë, rrallëherë mund të hasim në më shumë se një seancë paraprake. Palët tregojnë detajet e procesit gjatë seancës dëgjimore.

Gjykimi është aq jozyrtar saqë gjyqtari palëve u tregon përqindjen e shanseve që ata kanë për ta fituar apo humbur rastin. Seanca, shpesh përfundon me një marrëveshje midis palëve. Nëse nuk arrihet pëlqimi në mes palëve procedurale, në atë rast vendimi merret pas dëgjimit publik në seancën paraprake. Mesatarisht, proceset e tilla në të cilat zbatohen procedurat e lartpërmendura, përfundojnë zakonisht brenda gjashtë javëve.

Një përqindje e vogël e palëve, pas përfundimit të kësaj procedure, ata adresohen tek procedurat e tjera; edhe pse janë të lirë ta bëjnë një gjë të tillë⁴. Megjithatë, procedurat e shpejta sigurohen gjithashtu edhe për mbledhjen e shumave monetare. Përmbaruesit, me kusht që ata të punojnë së bashku me ata që kanë një shumë monetare për të marrë, i ftojnë debitorët në gjykatë dhe e përmbushin detyrën e tyre

² X.E. (Xandra) Kramer & E.A. (Alina) Ontanu - The functioning of the European Small Claims Procedure in the Netherlands: normative and empirical reflections; Published in *Nederlands Internationaal Privaatrecht* 2013(3), p. 319-328 & The European Small Claims procedure in the Netherlands Regulation (EC) No 861/2007 of the European Parliament and of the Council of 11 July 2007 establishing a European small claims procedure.

³ X.E. Kramer - The Dutch Kort Geding Procedure in an International Perspective: A Comparative View on Provisional Measures and Private International Law - Deventer: Kluwer, 2001 (This is the summary of a book as a result of a Ph.D. thesis defended at Leiden University on 26 April 2001).

⁴ De Rechtspraak - Practice direction for experts in Dutch civil law cases; (A book); page 8, 9, 11, 12, 13, 27, 28, 29, 30 - March 27 2018 & Elena Alina O. and Xandra E. Kramer - The Dutch perspective on cross-border small claims litigation: guarded optimism and pragmatism. A normative and empirical approach; Published in N. Neuwahl & S. Hammamoun (eds.), 'The European Small Claims Procedure and the Philosophy of Small Change' / 'La procédure européenne des petites créances ou la gestion d'un changement progressif', Montreal: Les Éditions Thémis 2014, p. 7 – 35.

publike në aspekt të ekzekutimit. Procedurën gjyqësore, zakonisht në këto raste e trajtojnë si alternativë të fundit. Zakonisht, kërcënimi se do të inicohet një procedurë për pagimin e borxhit është e mjaftueshme⁵.

PËR PJEKJET PËR REFORMA NË LIDHJE ME TË DREJTËN GJYQËSORE CIVILE

A) PËR PJEKJET PËR REFORMA NGA E KALUARA DERI MË SOT

E drejta gjyqësore holandeze bazohet mbi rregullat e përfshira në Ligjin mbi procedurën civile të vitit 1837 dhe mbi Ligjin mbi organizimin gjyqësor nga viti 1827. Normalisht të dy ligjet shumë shpesh janë ndryshuar dhe madje edhe më vonë me miratimin e Ligjit mbi ndihmën juridike dhe Ligjin mbi avokatët janë plotësuar shumë⁶. Pas një periudhe shumë të shkurtër pas miratimit të Ligjit për të drejtën procedurale në vitin 1838, për shkak të faktit që parimi i drejtpërdrejtshmërisë në gjykim nuk u preferua, për shkak të faktit se në gjykimin e rregullt iniciativa u la palëve dhe për shkak të faktit se gjyqtari nuk luan një rol aktiv në udhëheqjen dhe referimin e procesit, ky ligj ka qenë subjekt i shumë kritikave.

Përkundër të gjitha këtyre kritikave, ndryshimet në Ligj u bënë të mundura vetëm në fund të shekullit të 19-të⁷. Sistemi i gjyqësisë civile holandeze ka ndikime të caktuara nga paraardhësit francezë. Në të kaluarën edhe ligji gjerman për të drejtën procedurale ishte një model në drejtim të përpjekjeve të modernizimit. Megjithatë, reformat bazë u bënë vetëm në vitin 2002⁸. Një nga ndryshimet më të rëndësishme të

⁵ See The Dutch Bankruptcy Act (Faillissementswet) into force from September 1, 1896; Article 3- Immediate additional request for the application of the Debt Repayment Scheme; Article 3a - Request for a bankruptcy order and for a Debt Repayment Scheme order; Article 4 - Formal requirements for a request for a bankruptcy order. Online version of the Act we can find at: <http://www.dutchcivillaw.com/bankruptcyact.htm> .

⁶ Code of Civil Procedure-1837; Judiciary Organisation Act - 1827; Act on Advocates 1952; version of 01.05.2016 (https://www.ccbe.eu/fileadmin/speciality_distribution/public/documents/National_Regulations/National_Laws_on_the_Bars/EN_The-Netherlands_Act-on-Advocates.pdf) .

⁷ Sima Avramović - Mixture of Legal Identities: Case of the Dutch (1838) and the Serbian Civil Code (1844); Annals FLB – Belgrade Law Review, Year LXVI, 2018, No. 4; UDC 347:340.134(497.11:492)“18” CERIF: H300 ; DOI: 10.5937/AnaliPFB1804013A; page 13-33.

⁸ Déirdre Dwyer - The Influences of the CPR on Civil Procedure and Evidence Reform in the Netherlands; in the book - The Civil Procedure Rules Ten Years On; 2009; Print ISBN-13: 9780199576883; Published to Oxford Scholarship Online: March 2012.

bëra në Ligjin e procedurës civile është ajo që është bërë në janar të vitit 2002⁹. Në shtator të vitit 2005, si rezultat i reformave të vitit 2002, u bënë edhe reforma të tjera. Këto reforma, pavarësisht se kanë qenë si rezultat i reformave të vitit 2002, herë pas here, është vërejtur fakti se, ato e kanë tejkaluar atë që të jenë vetëm ndryshime teknike. Në vitin 2001, u formua një grup punues¹⁰ prej tre profesorëve universitarë dhe u kërkua prej tyre që të përgatisin ndryshime në gjyqësorin holandez. Grupi punues përgatiti raportin e përkohshëm në vitin 2003 dhe raporti përfundimtar u publikua në fillim të vitit 2006. Këtë herë, ndër të tjera, ndikim kanë pasur edhe reformat e Wolf-it¹¹.

Përveç ndikimeve të lartpërmendura, në reformat lidhur me njoftimet, autorizimet gjyqësore dhe dëshmitë (provat) gjyqësore ndikim kanë pasur edhe statutet e Bashkimit Evropian. Një tjetër tipar i kulturës ligjore holandeze është hapja e saj ndaj planit ndërkombëtar dhe ndikimeve të huaja. Duke marrë parasysh që nga 1 janari 2002, në organizimin gjyqësor u formua një institucion i ri i ashtuquajtur *Këshill*. Ky institucion është një institucion ndërmjetës në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe gjykatave ligjore dhe në mes këtyre institucioneve parashikon një koordinim në fushën e financimit të gjykatave, burimeve njerëzore, organizimit dhe strehimit të tyre¹².

B) REFORMA NGA VITI 2002

Projektligji për procedurën civile i është dorëzuar Parlamentit dy vjet para miratimit të tij. Një nga arsytet për këtë vonesë duhet theksuar cilësinë e Holandës dhe ajo është për shkak të harmonizimit (*polder model*) dhe arsyeja tjetër është përgatitja paraprake nga ana e komisionit e përbërë nga gjykatësit, avokatët dhe zyrtarët nga Ministria e Drejtësisë. Para reformave të vitit 2002, ka pasur veprime të ashpra në

⁹ Wetboek van Burgerlijke Rechtsvordering - Civil procedure Code of Netherlands with the changes of 2002. Online version: <http://www.dutchcivillaw.com/actconflictlawdescendancy.htm>

¹⁰ Jos L. T. Blank & Alex A.S. van Heezik - Policy reforms and productivity change in the judiciary system: a cost function approach applied to time series of the Dutch judiciary system between 1980 and 2016; February 2020-International Transactions in Operational Research 27(4):20; DOI: 10.1111/itor.12716, page 1-19.

¹¹ Michael Zander - The Woolf Reforms: What's the Verdict? The book - The Civil Procedure Rules Ten Years On;

The Civil Procedure Rules Ten Years On; Déirdre Dwyer - Print publication date: 2009 -Print ISBN-13: 9780199576883; Published to Oxford Scholarship Online: March 2012.

¹² Nuno Garoupa, Tom Ginsburg - Judicial Reputation: A Comparative Theory; a book; page 123.

parlament lidhur me nevojën për të rishikuar gjyqësorin. Duke vendosur që baza e këtij rishikimi mund të gjendet jashtë vendit, në vitin 1999, vëmendje iu kushtua reformave të gjyqësorit anglez. Pas diskutimeve të gjera, në janar të vitit 2002 janë bërë një sërë reformash në Gjyqësinë Civile Holandeze¹³. Dihet gjerësisht se reformat e vitit 2002 ishin të ndikuara nga modeli gjerman¹⁴, gjersa ligjvënësi në atë kohë ka qenë i ndikuar nga zhvillimet në Evropë. Në përgatitjet paraprake të kryera nga komisionet, janë propozuar dy pika që kanë rëndësi të madhe.

1. Procedura e përshpejtuar

Nga ana e një prej komiteteve për “Procedurën e përshpejtuar” që ka bërë përpjekjet paraprake të cilat përpjekje janë baza e reformave të vitit 2002, në vitin 1995 u pat kërkuar që të kryeëj hetime në lidhje me rregullat e gjykatës nga proceset e thjeshta që hasen në gjykata të ndryshme. Qëllimi i procedurës së përshpejtuar është të përcaktojë afatet e shkurtra për paraqitjen e parashtresave dhe shqyrtimin e rezultateve të tyre. Prandaj, është paramenduar që të mund të paraqiten vetëm kërkesat për fillimin (inicimin) e procedurës dhe llojet e tjera të parashtresave, e jo replikat dhe duplikat. Është parashikuar që palët procedurale të jenë personalisht të pranishme, gjersa gjyqtarët në një mënyrë miqësore të kërkojnë mundësi për të gjetur zgjidhje ose të paktën të bëjnë përpjekje të mbledhin të dhëna të dobishme për zgjidhjen e kontestit. Nëse konstatohet se nuk është e mundur të gjendet një zgjidhje në mënyrë miqësore; parashikohen disa dispozita që rregullojnë gjykimin midis palëve, përfaqësuesve të tyre dhe gjyqtarit, si dhe dëgjimin e dëshmitarëve¹⁵. Kjo kërkesë pilot është aplikuar në gjykata të ndryshme. Pasi që nuk ka asnjë detyrim për të marrë pjesë, është vërtetuar se palët dhe përfaqësuesit e tyre e kanë zgjedhur këtë procedurë në mënyrë të pavarur.

Palët procedurale që marrin pjesë vullnetarisht në këtë aplikim pilot, nëse janë pajtuar brenda tre deri katër muajve, ose është arritur deri tek zgjidhja me një vendim paraprak të gjykatës, atëherë mund të vazhdohet me gjykimin dhe me mbledhjen e provave. Ky eksperiment

¹³ Frits Bakker, Frans van Dijk, Christa Wiertz-Wezenbeek, Wilfried Derksen, Rosanna Kouwenhoven - Judicial reform in the Netherlands; *Rechtstreeks*; Scientific magazine for the judiciary organisation of the Netherlands; ISSN 1573-5322; page 9-42; 2014.

¹⁴ C. H. van Rhee - *European Traditions in Civil Procedure*; (a book), page 13, 2005.

¹⁵ Rhee, C.H. van & Verkerk, R.R. - *The Netherlands: A no-nonsense approach to civil procedure reform*. page 1-10, from a book- *Civil Litigation in China and Europe*, 2014.

ishte i suksesshëm dhe në reformën e vitit 2002 “Procedura e Përshejtuar” u shndërrua në një procedurë standarde.

2. Afatet e caktuara

Sipas një sondazhi të kryer nga një tjetër komitet në përputhje me veprimtarinë e gjykimit civil, u arritën rezultatet në të cilat; Procedura e përshpejtuar do të jetë e suksesshme vetëm nëse ndihet e pranishme përgjegjësia e gjyqtarit dhe e shtetit për sjelljet e vendimeve në afat të caktuar, nevojën për tërheqjen e diversitetit të procedurave në gjykatat e shkallës së parë dhe duke përgatitur një listë të unifikuar që përmban datat e seancave dhe caktimi i dënimeve nëse veprimet e procedurës nuk kryhen në afate të paracaktuara. Komiteti ka përgatitur një listë statutore për seancat gjyqësore dhe tek ky statut janë ndërfutur disa rregulla gjatë parashtrimit të parashtrësive dhe gjatë kësaj vonesat që mund të lindin. Për shkak të faktit se komisioni përbëhej kryesisht nga gjyqtarë, propozimet e përfshira në projekt janë gjykuar nga gjykatat si të përshtatshme dhe statuti është miratuar më 1 shtator 2000 para Ligjit të reformës. Kështu, sa i përket paraqitjes së parashtrësive, dorëzimit të raportit dhe përcaktimit të afateve, në gjykatat e Holandës është filluar me zbatimin e rregullave të njëjta¹⁶.

3. Parimet Themelore të përfshira në Projektligjin për Reformat e vitit 2002

Në Memorandumin e shpjegimit të Projektligjit¹⁷ paraqiten pesë parimet themelore që duhet të përfshihen rregullisht në të gjitha reformat e gjyqit civil: a) thjeshtëzimi i gjykimit, b) heqja e formaliteteve, c) modernizimi i marrëdhënieve midis palëve dhe gjyqtarit, ç) sigurimin dhe vazhdimin e aktiviteteve gjatë gjykimit dhe d) unifikimin e të drejtës gjyqësore.

a) Thjeshtëzimi i procedurës gjyqësore

Gjykimi i shkallës së parë është thjeshtuar në atë mënyrë që, nëpërmjet të inicimit të procedurës me anë të shkresës dhe nëpërmjet të inicimit të procedurës normale si bazë është marr aplikimi i vetëm i

¹⁶ For more details see: Code of Civil Procedure of Netherlands; articles: 114-119; 143; 276; 339; 358; 383; 391; 402; 426.

¹⁷ Juan Carlos Botero; Rafael La Porta; Florencio Lopez de Silanes; Andrei Shleifer; Alexander Volokh - An sc.paper: Judicial Reform; World Bank Research Observer, Vol. 18, No. 1, pp. 61-88, Spring 2003.

përgjithshëm. Në gjykatat regjionale të varura (pretendime-kërkesat me rëndësi të vogla, proceset e biznesit, qiratë dhe kontestet e agjencisë) nuk ekzistojnë procedura të ndryshme; me fjalë të tjera, procedurat në gjykatat rajonale dhe procedurat gjyqësore nga rajonet vartëse janë të njëjta¹⁸.

Procedura e përgatitjes me shkrim është reduktuar në vetëm një fazë; për shembull - thirrja (ftesa) gjyqësore (neni 111)¹⁹ dhe shkresa për përgjigje (neni 128)²⁰. Pasi pala e paditur të japë një përgjigje, gjyqtari do të vendosë që palët dhe përfaqësuesit e tyre të jenë prezent në gjykatë pas një muaji (neni 131)²¹. Arsyeja për këtë është shqyrtimi nëse ekziston mundësia e zgjidhjes miqësore ndaj kontestit apo jo dhe / ose mbledhjes së të dhënave nga palët (neni 88)²². Replika dhe duplika në parim janë tërhequr. Prania e palëve në gjykatë është e detyrueshme. Megjithatë, nëse gjyqtari vendos që procesi nuk është i karakterit që palët duhet të jenë të pranishme, nuk është e detyrueshme që ata të jenë prezent. Në këtë gjendje, vazhdohet me procedurën e dhënies së përgjigjeve nga ana e palëve procedurale. Kjo është një nga ndryshimet më të rëndësishme në Reformë dhe është marrë nga “procedurat e përshpejtuara” të provuara tashmë në gjykata të ndryshme.

Duke e zvogëluar në një fazë të vetme përgatitjen me shkrim të palëve, të gjitha pretendimet dhe mbrojtjet e paraqitura nga palët procedurale, ftesat dhe përgjigjet e tyre; sillen në një situatë të tillë saqë duhet të gjitha këto të definohen. Palët, gjersa janë të pranishëm në seancë, përpiqen të zgjidhin procesin me pajtim dhe gjithashtu të mbledhin të dhënat e duhura. Përveç kësaj, nëse paraqitet dëshmi, sipas natyrës së provës, bëhen marrëveshje të ndryshme dhe vendoset mbi datën e mbajtjes së seancës. Gjyqtari është gjithashtu në gjendje të rikujtojë palët për mundësinë e zgjidhjes së procesit nëpërmjet organeve për ndërmjetësim. Me praninë e palëve në gjykatë, vendimi lidhur me paraqitjen e shkresave për përgjigje varet tërësisht nga vullneti i gjyqtarit. Nëse u jepet mundësia palëve procedurale që me deklaratë gojore të paraqesin pretendimet dhe mbrojtjet e tyre dhe të përfaqësuesve të tyre, në atë rast gjyqtari mund të vendosë që të mos kërkojë të paraqitet asnjë

¹⁸ Frans van Dijk - Improved Performance Of The Netherlands Judiciary: Assessment Of The Gains For Society; sc.paper at: International Journal For Court Administration; Vol. 6 No. 1, June 2014; ISSN 2156-7964; URL: <http://www.iacajournal.org> page 1-16, 2014.

¹⁹ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 111.

²⁰ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 128.

²¹ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 131.

²² Code of Civil Procedure of Netherlands, article 88.

parashtresë (neni 134)²³. Nëse palët janë të pranishme në gjykatë dhe kërkojnë nga gjykata që të paraqesin parashtresat e tyre, gjyqtari mund të japë lejen. Nëse marrim parasysh se në kohën e ligjit të mëparshëm parashtresat janë dërguan reciprokisht në vetëm 5 % të proceseve gjyqësore, thuhet se kjo dispozitë është në vend të kësaj. Brenda këtyre ndryshimeve, procedura e ftesës u shndërrua në një strukturë të ngjashme me procedurën e kërkesës: Kërkesa (neni 279), mbrojtja (neni 282) dhe seanca paraprake që pason pas mbrojtjes (neni 279)²⁴.

b) Reduktimi i formaliteteve

Në Ligjin Civil, “Zvogëlimi i formaliteteve” nënkupton lidhjen me sanksione ndaj dështimeve procedurale vetëm nëse preken interesat që janë objekt mbrojtjeje. Në juridiksionin e gjykatës së apelit vërehet se lëshimet në lidhje me procedurën e kërkesës dhe procedurat e tjera shpesh korrigjohen me një “urdhër për korrigjim”. Një dispozitë tjetër, e cila është “dispozita kyçe” (nenet 69-76) tregon se ideja e reduktimit të formaliteteve është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme. Në rast se një kontest është inicuar me një procedurë të gabuar, kjo duhet të refuzohet menjëherë. Gjyqtari në këtë rast, në mënyrë që procedura të menaxhohet siç duhet, procedurën mund ta ndryshoj duke e anuluar fillimisht. Në këtë rast, edhe proceset nuk rrjedhin dhe procesi konsiderohet ekzistues që nga ekzekutimi i veprimit të parë (neni 69). Një rast i ngjashëm ndodh kur paditësi e inicon procesin gjyqësor në gjykatë të gabuar (neni 70). Për shembull, në vend që të inicohet procedura gjyqësore në gjykatë në një rajon vartës, ajo inicohet në gjykatën rajonale, atëherë gjykata e referon këtë proces në gjykatën nga një rajon i varur (neni 71). Llogaria e hapur, gabimet e drejtshkrimit, etj.; pas adresimit nga ana e palëve korrigjohen nga gjyqtari, pa iu referuar gjykatës së apelit²⁵.

c) Modernizimi i marrëdhënieve gjyqtarë-palë procedurale

Tradicionalisht, mënyra e funksionimit të gjykatave ligjore në Holandë është pasive. Fillimi, kryerja dhe përfundimi i procedurave kontestuese gjyqësore kryhet me zgjedhjen fakultative të palëve procedurale. Ngjarjet dhe të drejtat jo-kontestuese bëhen definitive dhe të zbatueshme (Neni 149). Si rezultat i kritikave për gjatësinë e gjykimit,

²³ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 134.

²⁴ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 279 & 282.

²⁵ See Code of Civil Procedure of Netherlands, article 69-76.

gjykatat në lidhje me transferimin dhe udhëheqjen e gjykimit fitojnë një rol të rëndësishëm që dita-ditës është në rritje.

Në dispozitat e përgjithshme në lidhje me procesin gjyqësor, rregullohet që gjyqtari, me qëllim të parandalimit të vonesave që nuk janë të arsyeshme, duhet të marrë masat e duhura. Datat e seancave janë të rregulluara në nivel kombëtar, zvogëlohet numri i ftesave gjyqësore dhe përgjigjeve në ato ftesa; gjersa gjatë kohës kur pala procedurale prezente në seancë përgjigjet në pyetjet e parashtruara - gjyqtari ka një rol aktiv të zmadhuar; e cila gjë e bën gjyqtarin një faktor përcaktues në drejtimin e procesit. Sipas faktit se gjyqtari është i autorizuar të kërkojë çdo lloj shpjegimi, regjistrimi dhe paraqitje të dokumenteve në çdo fazë të seancës, nëse palët procedurale nuk i plotësojnë këto kërkesa nga gjyqtari, gjyqtari ka autorizim që të sjell vendim të kundërt. Diçka që, sipas standardeve holandeze, mund të llogaritet si revolucionar është pranimi i rregullores së përgjithshme në lidhje me ngjarjet e sakta dhe të vërteta nga palët dhe nga përfaqësuesit e tyre; ngjarje këto që mund të kenë ndikim në vendimmarrjen e gjyqtarit²⁶.

ç) Sigurimi i aktivitetit gjatë gjykimit

Në një gjykim civil, monitorimi i aktivitetit jo vetëm që zvogëlon numrin e parashtrësive me shkrim, por gjithashtu mundëson edhe përgatitjen më të detajuar të ftesës për në gjykatë dhe përgjigjen në ftesën e tillë. Është parashikuar që gjyqtari të vij deri tek ideja e duhur për procesin gjyqësor, që nga fazat shumë të hershme të procesit. Në të njëjtën kohë, tek ftesa, tek e cila theksohet nevoja për praninë personale të të pandehurit, përveç thirrjes duhet të përfshihen edhe aktakuza dhe argumentet, dhe në të njëjtën kohë edhe mbrojtja. Paditësi duhet të definojë provat që posedon dhe dëshmitarët të cilët do duhet të dëgjohen (neni 111). Pala e paditur duhet të paraqesë një parashtrësë me shpjegim, dëshminë që posedon dhe dëshmitarët që duhet të dëgjohen (Neni 128)²⁷.

²⁶ European Network of Councils for the Judiciary ENCJ - Judicial Reform in Europe - part II - Approved by the General Assembly, Sofia, 7 June 2013, page 7-8. *If the Judiciary are to engage with and even steer the reform process at every stage and if they are to lead the implementation of the process in the courts it will be necessary that relevant training is in place to ensure they are effective in the judicial management issues using basic business principles of reform. Also; judicial Councils should develop education programmes to instil an understanding of the role the Judiciary and Judicial Councils have in the reform process. Appropriate and pertinent training should be provided for the Judiciary, to allow judges to become fully engaged with the reform process.*

²⁷ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 111 & 128.

Nëse i pandehuri dhe i padituri nuk i përmbushin kërkesat e nevojshme, gjyqtari merr vendim që dokumentet të cilat mungojnë të rimbursohen. Suksesi i procedurës së re ka të bëjë me masën me të cilën gjyqtari i shtyn palët procedurale në lidhje me përmbushjen e detyrave që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve.

Informacioni i fundit tregon që procesi nuk duhet të zgjas më shumë se gati një vit. Është paraparë që aktiviteti të forcohet me kufizimet e vendosura nga vendimi që shkon në apelacion (nenet 337 / II dhe 358 / III)²⁸.

d) Unifikimi i gjyqësorit civil

Ligjvënësi i ka unifikuar afatet e apelit si “një javë”, “katër javë”, “tre muaj”. Nga ana tjetër, në gjykimin e shkallës së parë, ndryshimet midis procedurës gjyqësore me ftesë gjyqësore dhe procedurës me një mënyrë tjetër u hoqën²⁹.

4. Përfundimi që del nga reforma e vitit 2002

Para së gjithash, lidhur me procedurat e shkallës së parë, janë hequr dallimet në rregullat për gjykim në gjykatat lokale (dhe gjykatat rajonale) dhe për të dy gjykatat janë miratuar rregulla të përbashkëta. Ky ndryshim është i ngjashëm me ndryshimin e bërë në mes të gjykatave të qarkut dhe gjykatave themelore në Angli dhe Uells³⁰. Si një nga ndryshimet më të rëndësishme të bëra me reformën në vitin 2002 mund të thuhet se janë ndryshimet si vijojnë: Miratimi i rregullave nga ana e këshillit gjyqësor pa kaluar procedura e tillë në organin Ligjvënës; gje-gjesisht në Parlament, vullnetarisht ose me kërkesë të palëve procedurale i është dhënë autorizimi gjykatësit që të mund të ndërmer masa për parandalimin e vonesave, pastaj nëse thyhen rregullat për mënyrën e inicimit të procedurës gjyqësore dhe nëse kjo shkelje ligjore dëmtohet e drejta që duhet të mbrohet në këtë rast gjykatat jo-kompetente kanë autorizim të plotë për ta transferuar procesin tek gjykatat kompetente, largimi nga tradita e zbulimit të vogël të të dhënave në fazat e para të

²⁸ Code of Civil Procedure of Netherlands, article 337 / II and 358 / III.

²⁹ Expert Group of Ms. Helen Burrows, Dr. Jens Johannes Deppe, Prof. Giuseppe Di Federico, Mr. Marco Fabri, Mr. Francesco Contini, Prof. Antoine Hol, Mr. Joseph Chu’ma Otteh, Dr. Nihal Jayawickrama, Dr. Brian Ostrom - worked for UNODC - (A Guide) - Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity - United Nations New York, 2011, page 113, 128, 130.

³⁰ For more see: Bobette Wolski - Reform of the Civil Justice System 25 Years Past: (In)Adequate Responses from Law Schools and Professional Associations? (And How Best to Change the Behaviour of Lawyers) - Common Law World Review 40(1):40-93; March 2011.

procesit dhe dhënia e autorizimit të paditësit dhe të pandehurit për ofrimin paraprak të të dhënave në kërkesat e tyre dhe në dhënien e përgjigjeve të tyre, zvogëlimi i numrit të parashtresave të nevojshme që paraqiten gjatë gjykimit, pas parashtrimit të përgjigjes nga ana e të pandehurit - detyrimi i gjyqtarit që të marr vendim në lidhje me praninë personale të palëve në gjykatë dhe si e fundit, tërheqja e mundësisë së apelimit për vendimet e përkohshme³¹.

Kështu, mund të themi se, brenda një periudhe të shkurtër kohore, ligjvënësi arriti të ndryshonte gjërat themelore në sistemin civil holandez. Kjo reformë e Ligjit Civil mund të kualifikohet si një produkt tipik i modelit holandez të pajtimit (*modeli polder*). Pas hyrjes në fuqi të reformës, menjëherë filluan kritikrat. Kritikrat i referohen faktit se në Ligjin e Ri në kuptimin e vërtetë të fjalës nuk ka reforma themelore për një proces gjyqësor civil. Nëse merret parasysh gjykimi në shkallë të parë, mund të shihet qartë se sistemi civil holandez është goditur nga një kornizë shumë e mirë logjike.

Procedura në shkallën e apelit pritet të ndjekë këtë. Në gjykimin e shkallës së parë, një parashtresë me shkrim paraqitet para organeve gjyqësore dhe menjëherë pas kësaj para një gjykatësi aktiv i cili do të udhëheq me procesin gjyqësor paraqiten personalisht palët procedurale, në përputhje me strukturën ekzistuese, e cila është e shpejtë dhe aktive. Gjithashtu janë caktuar datat e mbajtjes së seancave dëgjimore dhe për dorëzimin e parashtresave. Ende nuk ka dispozita lidhur me kërkesat e vogla. Më parë në Holandë për këtë ishte një procedurë që u hoq në vitin 1991³². Në këtë drejtim, në Bashkimin Evropian parashihet si bazë të merren rregullat e Unionit. Ende nuk ka rregulla të hollësishme lidhur me teknologjitë shkencore dhe terminologjinë gjyqësore. Vërehet se Gjykata e Apelit ka marrë vendime që rregullojnë përparimin në këtë fushë. Megjithatë, edhe për nga kjo temë pritet të shihet se çfarë do të ndodh në Bashkimin Evropian. Por si përfundim mund të thuhet se reforma e bërë në gjykatat e shkallës së parë në Holandë ishte e suksesshme³³.

³¹ Masahisa Deguchi & Marcel Storme - The reception and transmission of civil procedural law in the Global Society (a book) ; (IAPL); page 207-2012; 2008.

³² J.M. Barendrecht, K.F. Bolt, M.W. de Hoon - sc. paper: Appeal Procedures: Evaluation and Reform; Tilburg Law & Economics Center Discussion Paper No. 2006-031; page 8-47.

³³ Martin Della Chiesa -SPSC (Sciences Postrasbourg consulting)- Comparative study of the reforms of the judicial maps in Europe, 2012, pages - 5, 6, 9, 14, 21, 23, 24, 27, 32, 50.

C) REFORMA NGA VITI 2005

Më 15 tetor 2005, janë miratuar reformat e reja si rezultat i reformave të vitit 2002³⁴. Disa nga këto reforma vërtet shkuan përtej se të mbeten vetëm ndryshime teknike të shkaktuara nga Reformat në vitin 2002. Për shembull neni 6 dhe neni 8 i Ligjit Civil është ndryshuar dhe i është përshtatur Statutit I të Brukselit lidhur me njohjen dhe miratimin e Autorizimeve Ndërkombëtare dhe në lidhje me Njoftimet Gjyqësore për Çështjet Ligjore dhe Tregtare³⁵.

Ç) QASJA E RE E SISTEMIT CIVIL TË HOLANDËS

Siç u përmend më lart në Holandë, u formua një grup pune i përbërë nga profesorë universitar me qëllim për të bërë propozime për reforma themelore, të cilëve u është dhënë detyra që përsëri të vlerësojnë gjyqësorin holandez. Grupi i punës ka bërë një punë trefazore. Faza e parë përfundon me publikimin e një raporti të përkohshëm që shpjegon mendimet bazë të grupit punues; faza e dytë përbëhet nga debatet në mes akademikëve lidhur me raportin e përkohshëm. Së fundi, me publikimin e raportit përfundimtar të grupit punues përfundon faza e tretë³⁶. Në raportin e përkohshëm grupi punues është përqendruar në tema të tilla si: (1) kontestet, ndër metodat e tjera të zgjidhjes, për shembull ndërmjetësimi, të mund ky proces gjyqësor të kryhet nga gjykatat shtetërore (2) në njërën anë, si një mjet i fundit për faktin se gjykimi drejtohet nga organet shtetërore (gjykata) dhe nga ana tjetër, sjellja e gjykimit bëhet gjithashtu nga ana e organeve shtetërore sa i përket aspektit të interpretimit dhe zhvillimit të së drejtës si dhe nga aspekti i paditësve individual dhe i të pandehurve (Neni 6 i AIS) paraqet një ekuilibër të formësuar (3) Gjykimi nga ana e organeve shtetërore është i shpejtë, me shpenzime të arsyeshme aktive dhe me cilësi të lartë, (4) U jepej theks i veçantë rolit të gjyqtarit dhe palëve procedurale gjatë dhe para procedurës gjyqësore (5) U jepej theks i veçantë marrëdhënieve në mes gjykatave themelore dhe të apelit, qëllimit të parashtrimit

³⁴ Cornelis Hendrik v.R. - An Unsuccessful Attempt to Modernise Civil Procedure in the Netherlands in the Early Twentieth Century, J. Gudowski & K. Weitz (eds.), *Aurea praxis, aurea theoria*, Księga pamiatkowa ku czci Profesora Tadeusza Erecieskiego, Warsaw: LexisNexis, p. 1567-1588; specific pages -13, 14, 15; 2011.

³⁵ Dutch Civil Code, article 6 and 8.

³⁶ Van der Doelen, Frans - Coping with the crisis in the judicial system in the Netherlands, *Cepej*, nr.7, December 2010.

të apelimit dhe paraqitjes së ankesës (6) U jepej theks i veçantë nevojës për një gjykim sa më të pastër dhe fleksibil. Përveç kësaj, tek raporti i përkohshëm për herë të parë gjithashtu përmendet procedura komplekse gjyqësore³⁷.

CONCLUSION:

Although in the Republic of the Netherlands, despite the fact that there have been problems regarding the civil system in a judicial aspect, one-on-one civil-judicial reforms have been foreseen and taken. First of all, regarding the first instance procedures, the differences in the rules for trial in the local courts (and the regional courts) have been removed and common rules have been adopted for both courts. This difference is similar to the difference made between the district courts and the basic courts in England and Wales.

As one of the most important changes made with the reform in 2002 can be said to be the following changes: Approval of the rules by the judicial council without going through such a procedure in the Legislative body; that is, in Parliament, voluntarily or at the request of the procedural parties, the judge is given the authority to take measures to prevent delays, then if the rules on how to initiate court proceedings are broken and if this legal violation violates the right to be protected, in this case the incompetent courts have full authority to transfer the process to the competent courts, moving away from the tradition of small-scale data disclosure in the early stages of the process and authorizing the plaintiff and defendant to provide preliminary data in their requests and in giving their answers, reducing the number of necessary submissions that appear during the trial, after the submission of the answer by the defendant - the obligation of the judge to make a decision regarding the personal presence of the parties in court and, last but not least, the withdrawal of the possibility of appeal for interim decisions. Which means that, because there were problems in the civil-judicial procedure, in the Draft Law on Reforms of 2002, ie in the memorandum of explanation of the Draft Law are presented the five basic principles that should be regularly included in all civil court reforms: a) simplifi-

³⁷ Ibid.

cation of the trial b) abolition of formalities c) modernization of relations between the parties and the judge d) provision and continuation of activities during the trial and e) unification of judicial law.

Thus, in the Republic of the Netherlands from 2007 until today there is a high level tendency to use mediation outside and inside the court, in order to avoid civil litigation problems in procedural terms. Also, from 2013 until today in the Republic of the Netherlands, changes were made in terms of court fees in the civil judicial system, in order to avoid civil courts from overloading with cases.

BIBLIOGRAFIA:

• *X.E. (Xandra) Kramer & E.A. (Alina) Ontanu* - The functioning of the European Small Claims Procedure in the Netherlands: normative and empirical reflections; Published in *Nederlands Internationaal Privaatrecht* 2013(3), p. 319-328 & The European Small Claims procedure in the Netherlands Regulation (EC) No 861/2007 of the European Parliament and of the Council of 11 July 2007 establishing a European small claims procedure.

• *X.E. Kramer* - The Dutch Kort Geding Procedure in an International Perspective: A Comparative View on Provisional Measures and Private International Law - Deventer: Kluwer, 2001 (This is the summary of a book as a result of a Ph.D. thesis defended at Leiden University on 26 April 2001) .

• *Sima Avramović* - Mixture of Legal Identities : Case of the Dutch (1838) and the Serbian Civil Code (1844); *Annals FLB – Belgrade Law Review*, Year LXVI, 2018, No. 4; UDC 347:340.134(497. 11:492)“18” CERIF: H300; DOI: 10.5937/AnaliPFB1804013A; page 13-33.

• *Déirdre Dwyer* - The Influences of the CPR on Civil Procedure and Evidence Reform in the Netherlands; in the book - *The Civil Procedure Rules Ten Years On*; 2009; Print ISBN-13: 9780199576883; Published to Oxford Scholarship Online: March 2012.

• *Jos L. T. Blank & Alex A.S. van Heezik* - Policy reforms and productivity change in the judiciary system: a cost function approach applied to time series of the Dutch judiciary system between 1980 and 2016; February 2020 -*International Transactions in Operational Research* 27(4):20; DOI: 10.1111/itor.12716, page 1-19.

• *Michael Zander* - The Woolf Reforms: What’s the Verdict? The book - *The Civil Procedure Rules Ten Years On*; The Civil

Procedure Rules Ten Years On; Déirdre Dwyer - Print publication date: 2009 -Print ISBN-13: 9780199576883; Published to Oxford Scholarship Online: March 2012.

- **Nuno Garoupa**, Tom Ginsburg - Judicial Reputation: A Comparative Theory; a book; page 123.

- **Frits Bakker, Frans van Dijk, Christa Wiertz-Wezenbeek, Wilfried Derksen, Rosanna Kouwenhoven** - Judicial reform in the Netherlands; Rechtstreeks; Scientific magazine for the judiciary organisation of the Netherlands; ISSN 1573-5322; page 9-42; 2014.

- **C. H. van Rhee** - European Traditions in Civil Procedure; (a book), page 13, 2005.

- **Rhee, C.H. van & Verkerk, R.R.** - The Netherlands: A nonsense approach to civil procedure reform. page 1-10, from a book-Civil Litigation in China and Europe, 2014.

- **Juan Carlos Botero; Rafael La Porta; Florencio Lopez de Silanes; Andrei Shleifer; Alexander Volokh** - An sc.paper: Judicial Reform; World Bank Research Observer, Vol. 18, No. 1, pp. 61-88, Spring 2003.

- **Frans van Dijk** - Improved Performance Of The Netherlands Judiciary: Assessment Of The Gains For Society ; sc.paper at: International Journal For Court Administration; Vol. 6 No. 1, June 2014 ; ISSN 2156-7964 ; URL: <http://www.iacajournal.org> , page 1-16, 2014.

- **Ms. Helen Burrows, Dr. Jens Johannes Deppe, Prof. Giuseppe Di Federico, Mr. Marco Fabri, Mr. Francesco Contini, Prof. Antoine Hol, Mr. Joseph Chu'ma Otteh, Dr. Nihal Jayawickrama, Dr. Brian Ostrom**- worked for UNODC - (A Guide) - Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity - United Nations New York, 2011, page 113, 128, 130.

- **Masahisa Deguchi & Marcel Storme** - The reception and transmission of civil procedural law in the Global Society (a book) ; (IAPL); page 207-2012; 2008.

- **J.M. Barendrecht, K.F. Bolt, M.W. de Hoon** - sc. paper: Appeal Procedures: Evaluation and Reform; Tilburg Law & Economics Center Discussion Paper No. 2006-031; page 8-47.

- **Martin Della Chiesa** -SPSC (Sciences Postrasbourg consulting)- Comparative study of the reforms of the judicial maps in Europe, 2012, pages - 5, 6, 9, 14, 21, 23, 24, 27, 32, 50.

• ***Cornelis Hendrik v.R.*** - An Unsuccessful Attempt to Modernise Civil Procedure in the Netherlands in the Early Twentieth Century, J. Gudowski & K. Weitz (eds.), *Aurea praxis, aurea theoria*, Księga pamiątkowa ku czci Profesora Tadeusza Erecieskiego, Warsaw: LexisNexis, p. 1567-1588; specific pages -13, 14, 15; 2011.

• ***Bobette Wolski*** - Reform of the Civil Justice System 25 Years Past: (In)Adequate Responses from Law Schools and Professional Associations? (And How Best to Change the Behaviour of Lawyers)' - *Common Law World Review* 40(1):40-93; March 2011.

• ***Dutch Civil Procedure Code***, articles: 69-76, 88, 111, 114-119, 128, 131, 134, 143, 276, 279-282, 337/II, 339, 358, 358/III, 383, 391, 402, 426.

• ***Dutch Civil Code***, articles: 6, 8.

• ***Dutch Bankruptcy Act*** (Faillissementswet) into force from September 1, 1896; Article 3, 4.